


# ANALIZA E KORNIZËS LIGJORE NË LIDHJE ME TË DREJTAT E LGBTI KOMUNITETIT

KOMITETI I  
 **HELSINKIT**   
PËR TË DREJTAT E NJERIUT  
I REPUBLIKËS SE  
MAQEDONSE

 **LGBTI**  
центар за поддршка  
gender per per'krahe  
support centre





Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si pasqyrim i pikëpamjeve të CIVICA Mobilitas, Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) ose organizatat që ushtrojnë.

**Botues:**

Komiteti i Helsinkit për të drejtat e njeriut  
në Republikën e Maqedonisë përfaqësuar  
nga Kryetari Prof. Dr. Gordan Kallajxhiev

**Redaktor:**

Uranija Pirovska  
Kocho Andonovski

**Autorë:**

Vildan Drpljanin  
Ivan Menkinoski

**Лектор:**

Дејан Василевски

**Пërpunimi teknik i shtypjes:**

Koma deisgn Studio

**Shtyp:**

Vinsent grafika

CIP - Каталогизација во публикација  
Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

342.7-055.34:340.13(497.7)(047)

DRPLJANIN, Vildan

Analysis of the legal framework for the protection of the rights of the LGBTI  
community) / [Vildan Drpljanin, Ivan Menkinoski ; translation Maja Angeleska].

- Скопје : Helsinki committee for human rights of the Republic of Macedonia,  
2017. - 21 стр. : табели ; 21 см


Публикацијата е во рамките на проектот: "Civika Mobilitas"

ISBN 978-608-4790-16-7

1. Menkinoski, Ivan [автор]

а) Сексуални права - Правна рамка - Македонија - Извештаи  
COBISS.MK-ID 103780362

# Përmbajtje



<b>I</b>	<b>Hyrje</b> .....	7
<b>II</b>	<b>Përshkrim i problemeve dhe zgjidhjet e preferuara ligjore</b>	
1.	Miratimi i strategjisë për tejkalimin e homofobisë dhe transfobisë .....	11
2.	Ndryshim i Ligjit për Parandalim dhe Mbrojtje nga Diskriminimi .....	13
3.	Ndryshimi i Kodit Penal.....	14
4.	Ndryshim i Ligjit për Familje .....	15
5.	Miratimi i rregullores për njohje sistematike të ndryshimit të gjinisë .....	16
<b>III</b>	<b>Legjislatura pozitive në lidhje me LGBTI komunitetin</b> .....	19
	Ligji për Mbrojtje, Parandalim dhe Pengim nga Dhuna Familjare .....	19
	Ligji për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele .....	20
	Ligji për Shëndet Publik .....	20
	Ligji për Plotësim dhe Ndryshim të Ligjit për Familje - Kujdestari mbi persona të mitur - viktima të tregtisë me qenie njerëzore .....	21
	Ligji për të Drejtat e Pacientëve .....	21
	Ligji për Arsimin e Lartë .....	21

Rregullore për teknika të reja reklamuese - Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.....	22
Udhëzim për Vendosjen e Produkteve - Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.....	22
<b>IV</b> Hulumtime ndërkombëtare dhe tregues dhe rekomandime për RM-në.....	23
REKOMANDIME në lidhje me kornizën ligjore për të drejtat e LGBTI komunitetit në Republikën e Maqedonisë .....	29
<b>V</b> Konkluzion .....	31
Bosnja dhe Hercegovina.....	33
Kosova.....	34
Shqipëria .....	35
Mali i Zi.....	35
Serbia .....	36
Turqia .....	37

# I Hyrje

Homofobija dhe transfobija edhe pas 25 viteve pavarësi të Republikës së Maqedonisë ende janë shumë të pranishëm në pothuaj se gjitha segmentet e jetës së përditshme. Raportet vendore dhe ndërkombëtare për gjendjen e të drejtave të personave LGBTI, pa asnjë përjashtim, vendosin dritë mbi gjendjen e komunitetit si një prej më të këqijave në Evropë. Mungesa e vullnetit politik, homofobija e hapur nga përfaqësues të lartë të institucioneve dhe mungesa e funksionalitetit të sistemit juridik, paraqiten si pengesa kryesore për realizimin e parimit të barazisë për gjithë qytetarët. Shembuj për këtë janë raportet e përparimit të Republikës së Maqedonisë ndaj Bashkimit Evropian<sup>1</sup>, në të cilët shteti vazhdimisht kritikohet për dobësitë e përgjithshme në zbatimin e standardeve për të drejtat e njeriut, që ndikojnë mbi grupet më të cenuar dhe marginalizuar të shoqërisë, siç është edhe LGBTI komuniteti. Përveç kësaj, raportet në organizim të ILGA Evropë<sup>2</sup>, që lufton për të drejtat e LGBTI personave dhe publikon listën e 49 vendeve sipas nivelit të respektimit të të drejtave të njeriut në këtë komunitet, vazhdimisht vendosin Maqedoninë në fund të listës.

Në sipërfaqe paraqiten ende problemet sistemore që institucionet dhe e drejta pozitive nuk arrijnë të tejkalojnë, i tejkalojnë shumë ngadalë ose i thellojnë. Problemet themelore përbëhen në mungesën e saktësisë ose në përmbajtjen diskriminuese të dispozitave ligjore, mungesa e ekspertizës dhe trajnimit të përfaqësuesve të institucioneve dhe mungesa e mbrojtjes

1 Raporte të Komisionit evropian për Republikën e Maqedonisë për vitin 2012, 2013, 2014, 2015 dhe 2016: <https://goo.gl/SCM7Xn>, <https://goo.gl/CwUa56>, <https://goo.gl/VDSJTs>, <https://goo.gl/azwqB2>, <https://goo.gl/SQxrrV>.

2 Raporte të ILGA Evropë për gjendjen me LGBTI të drejtat në Republikën e Maqedonisë për vitin 2012, 2013, 2014, 2015 dhe 2016: <http://www.ilga-europe.org/who-we-are/organisational-documents/annual-reports>.

efikase ligjore. Në Republikën e Maqedonisë, Gjykata Kushtetuese, Komisioni i Përhershëm Anketues për Mbrojtjen e Lirive dhe të Drejtave të Qytetarëve në sajë të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, Avokati i Popullit, Komisioni për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe gjykatat janë mekanizmat shtetëror për mbrojtjen e të drejtave të njeriut që kanë mandat të qartë për përballimin me diskriminimin në përgjithësi, por në praktikë, strukturat e të drejtave të njeriut nuk ndërmarrin asnjë masë në lidhje me orientimin seksual dhe identitetin gjinor. Ligjet pozitive sjellin shkëlqje të vazhdueshme të të drejtave dhe lirive të LGBTI personave në Republikën e Maqedonisë dhe nuk ofrojnë asnjë mbrojtje për komunitetin. Legjislatura nuk i përfshin orientimin seksual dhe identitetin gjinor si baza të veçanta për mbrojtje dhe me atë pjesëtarët e komunitetin mbesin të cenuar dhe të ekspozuar në trajtim të ndryshëm nga heteroseksualët.

Kjo analizë do të jep një përshkrim të shkurtër të problemeve kryesore të legjislaturës, si dhe një plotësim me sugjerime konkrete për tejkalimin e tyre. Analiza është ndarë në tre pjesë me qëllim të zbulimit të saktë të problemeve pa mos shkelur atë që vetëm është zbatuar dhe arritur. Pjesa e parë do të analizojë zgjidhjet e preferuara ligjore, siç janë miratimi i strategjisë për tejkalimin e homofobisë dhe transfobisë, ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për Parandalimit dhe Mbrojtjes nga Diskriminimi<sup>3</sup>, Kodi Penal<sup>4</sup>, dhe Ligjin për Familje<sup>5</sup>, siç dhe miratimi i rregullores për njohjen sistematike të ndryshimit të gjinisë. Më tutje, në pjesën e dytë, për të krijuar një pasqyrë të legjislaturës aktuale në lidhje me LGBTI personat, janë dhënë dispozitat ligjore dhe aktet nënligjore që përmendin dhe rregullojnë të drejtat e lidhur me orientimin seksual dhe identitetin gjinor. Më konkretisht, janë përfshirë gjashtë ligje, Ligji për Mbrojtje, Parandalim dhe Ndalim të Dhunës Familjare<sup>6</sup>, Ligji për Shërbime Audio dhe Audio-Vizuale Mediatike<sup>7</sup>, Ligji për Shëndet Publik<sup>8</sup>, Ligji

08...

3 Ligji për parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi “Gazeta zyrtare e RM”, nr. 117/2015.

4 Kodi penal i Republikës së Maqedonisë, “Gazeta zyrtare e RM”, nr. 37/96.

5 Ligji për familje, neni 15, “Gazeta zyrtare e RM”, nr. 80/92, 9/96, 38/2004, 33/2006 dhe 84/2008.

6 Ligji për mbrojtje, parandalim dhe prevenim nga dhuna familjare, “Gazeta zyrtare e RM”, nr. 138/2014.


7 Ligjin për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale, “Gazeta zyrtare e RM”, nr. 184/13, 101/14 dhe 132/14.

8 Ligji për shëndet publik, “Gazeta zyrtare e RM”, nr. 22/2010.




për Ndryshim dhe Plotësim të Ligjit për Familje<sup>9</sup>, Ligji për të Drejtat e Pacientëve<sup>10</sup>, Ligji për Arsimin e Lartë<sup>11</sup>, si dhe Rregullorja për Teknika të Reja Reklamuese<sup>12</sup> dhe Manuali për Vendosjen e Produkteve<sup>13</sup>, të miratuar nga Agjencia për Audio dhe Audio-Vizuale Mediatike. Në fund, në pjesën e tretë janë pasqyruar përvojat ndërkombëtare me anë hulumtimeve dhe treguesve dhe janë dhënë rekomandime konkrete si të tejkalohen problemet aktuale dhe të krijohet një atmosferë dhe klimë e pranimit. Analiza ka të bëjë me gjitha organet e interesuara për mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve dhe organeve tjera jo-gjyqësore dhe tema lidhur me punën e tyre. Analiza është synuar për informim të publikut mbi legjislaturën e të drejtave dhe lirive të njeriut për LGBTI personat dhe mund të shërbejë si manual për ligjvënësin në periudhën e rëndësishme reformuese të vijon.

## ...09



- 9 Ligji për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për familje, “Gazeta zyrtare e RM”, nr. 153/2014.
- 10 Ligji për të drejtat e pacientëve, “Gazeta zyrtare e RM”, nr. 12/2009.
- 11 Ligji për arsim të lartë, “Gazeta zyrtare e RM”, nr. 35/08, 103/08, 26/09, 83/09, 99/09, 115/10, 17/11, 51/11, 123/12, 15/13, 24/13, 41/14, 116/14, 130/14, 10/15, 20/15, 98/15, 145/15, 154/15 dhe 30/16.
- 12 Rregullore për teknika të reja për reklama, “Gazeta zyrtare e RM”, nr. 56/2015.
- 13 Udhëzime për vendosjen e produkteve, “Gazeta zyrtare e RM”, nr. 201/2014.



# II Përshkrim i problemeve dhe zgjidhjet e preferuara ligjore

... 11

## 1. Miratimi i strategjisë për tejkalimin e homofobisë dhe transfobisë

Për momentin, nuk ka ndonjë strategji e plotë ose tjetër për përballimin me diskriminimin, stereotipat dhe paragjykimet lidhur me orientimin seksual ose identitetin gjinor. Përkundër, përfaqësuesit e institucioneve me fjalimet e tyre publike i zmadhojnë paragjykimet dhe stereotipat për LGBTI personat. Ish Ministri i Punës dhe Politikës Sociale ka ngritur çështjen e martesave me gjini të njëjtë dhe birësimit të fëmijëve nga çiftet e gjinisë së njëjtë pa asnjë debat ose mendim për këto çështje nga ana e LGBTI komunitetit<sup>14</sup>. Me atë, Ministri edhe njëherë në mënyrë publike ka prezantuar pozitën e Qeverisë në atë kohë për garantim të të drejtave të LGBTI personave dhe ka shkaktuar që LGBTI komuniteti të dënohet nga publiku pa asnjë arsye. Përveç faktit që në Strategjinë

14 "Nametnat ustav" – Diskutim publik mbi propozim amendamentet e Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë: <http://www.soros.org.mk/CMS/Files/Documents/FOOM-inserter-Nametnat-ustav.pdf>.

Kombëtare për Barazi dhe Jo-Diskriminim 2016-2020<sup>15</sup> përmenden orientimi seksual dhe identiteti gjinor, ajo bëhet vetëm në hyrjen dhe pa mos vendosur përqendrim në nevojat dhe problemet në tekstin vijues. Prej këtu, duke marrë parasysh që bëhet fjalë për disa grupe që kanë qenë të përfshirë me këtë strategji dhe unifikimi i problemeve me të cilat përballohen, me rëndësi është të miratohet një strategji e veçantë që do të mund të ofrojë mbrojtje të plotë. Për miratimin e strategjisë për tejkalimin e homofobisë dhe transfobisë ka nevojë për themelimin e një trupi ndër-sektoriale që do të përpilohet nga përfaqësues të qeverisë dhe përfaqësues të organizatave qytetare që punojnë në mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave të LGBTI personave, që kanë për detyrë krijimin dhe zbatimin e strategjisë. Si hap i parë ndaj zbatimit të strategjisë duhet të zhvillohen trajnime të veçanta për administratën shtetërore, policinë dhe gjyqësorin, për të ngritur vetëdijen dhe identifikim të diskriminimit në bazë të orientimit seksual dhe identitetin gjinor. Me këtë do të arrihet sensibilizim për çështjen e të drejtave të LGBTI personave dhe do të theksohet bashkëpunimi mes institucioneve dhe organizatave që operojnë në fushën e LGBTI komunitetit. Pjesa e dytë përfshin fushën e arsimit, në të cilën duhet bërë revizione të teksteve mësimore që përdoren në fazat e ndryshme të arsimit maqedonas dhe me të cilën do të largohen hulumtimet e pasakta ose të vjetra që në mënyrë të gabuar përfaqësojnë LGBTI komunitetin. Përveç kësaj, si një segment plotësues në pjesën e dytë, Ligji për Marrëdhënie Pune duhet të sigurojë të drejta dhe obligime të njëjta për gjithë të punësuarit pa dallim nga orientimi seksual dhe identiteti gjinor dhe nga kjo del që mbrojtja shëndetësore dhe sociale e LGBTI personave duhet të jetë njëlloj e gatshme si për të gjithë personat tjerë. Në pjesën e tretë të strategjisë për tejkalimin e homofobisë dhe transfobisë do të punohet në krijimin e perceptimit të LGBTI komunitetit në sport dhe fushat tjera. Mbështetja e tifozëve në sportet më të njohura shpesh dominon me brohoritje homofobike dhe transfobike dhe pothuaj se asnjëherë nuk merren masa. Shqiptimi i gjobave më serioze dhe bashkëpunimi i vazhdueshëm me grupet e tifozëve do të kontribuojë drejt uljes graduale të të folurit të urrejtjes në

12...

15 Strategjia kombëtare për barazi dhe mosdiskriminim 2016-2020: [http://arhiva.vlada.mk/registar/files/Nacionalna\\_strategjija\\_za\\_ednakvost\\_i\\_nediskriminacija\\_2016-2020.pdf](http://arhiva.vlada.mk/registar/files/Nacionalna_strategjija_za_ednakvost_i_nediskriminacija_2016-2020.pdf).

bazë të orientimit seksual dhe parandalimit të dhunës që del si pasojë e kësaj atmosfere. Në Republikën e Maqedonisë Ligji për Parandalim dhe Mbrojtje nga Diskriminimi përfshin edhe sferën e shtëpisë. Përveç faktit që orientimi seksual dhe identiteti gjinor nuk janë përfshirë në Ligjin, Komisioni për Mbrojtje nga Diskriminimi mund të njohë diskriminim në bazë të orientimit seksual dhe identitetit gjinor në fushën e shtëpisë. Megjithatë, shembujt nga praktika tregojnë kjo nuk ndodh shpesh ose pothuaj se asnjëherë. Nga kjo, ka një nevojë të shprehur të fushatave në lidhje me dispozitat kundër diskriminuese si dhe programet sociale, që do të përfshinin programe për mbështetje, që kanë të bëjnë me faktorët që rrisin cenueshmërisë dhe rrezikun nga humbja e shtëpisë së LGBTI personave, fëmijëve dhe të rinjve, si dhe skema për mbështetje dhe siguri në lagjen. Në pjesën e fundit, të katërt, të strategjisë do të bëhet ndryshim i disa ligjeve dhe akteve tjera ligjore me çfarë do të garantohen të drejtat themelore të njeriut të LGBTI personave. Këto akte ligjore janë: Ligji për Parandalim dhe Mbrojtje nga Diskriminimi, Kodi Zgjedhore, Ligji për Familje dhe Rregullorja për Njohje Sistematike të Ndryshimit të Gjinisë.

# ...13

## 2. Ndryshim i Ligjit për Parandalim dhe Mbrojtje nga Diskriminimi

Në Ligjin për Parandalim dhe Mbrojtje nga Diskriminimi, që ishte miratuar në vitin 2010, orientimi seksual nuk ishte përfshirë si një bazë e veçantë për mbrojtje nga diskriminimi. Identiteti gjinor, megjithatë, si bazë e veçantë për diskriminim, nuk ishte marrë parasysh aspak gjatë përgatitjes së ligjit. Sipas Nenit 3 të Ligjit për Parandalim dhe Mbrojtje nga Diskriminimi, bazat e diskriminimit janë numëruar në mënyrë taksative dhe mes tyre nuk gjendet ndalimi i diskriminimit në bazë të orientimit seksual dhe identitetit gjinor. Ndonëse përkatësia e grupit të marginalizuar ekziston si bazë për ndalimin e diskriminimit, interpretimi dhe marrja e rasteve në këtë grup mbetet tërësisht në duart e gjykatësve. Praktika e deritanishme gjyqësore nuk ka treguar rezultate pozitive ose raste kur orientimi seksual dhe identiteti gjinor kanë qenë vendosur në bazën “përkatësi të grupit të marginalizuar”. Ka disa raste në të cilat Komisioni për Mbrojtje nga Diskriminimi ka miratuar vendime pozitive për diskriminim për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor, që

i ka shqyrtuar nën fushën “çdo bazë tjetër” megjithatë numri i tyre është shumë i vogël dhe jo-proporcional me nevojën e vërtetë të mbrojtjes. Për këto arsye, duhet të inkorporohet orientimi seksual dhe identiteti gjinor si baza të veçanta për diskriminim, për të siguruar respekt të plotë të të drejtave të njeriut të lezbikeve, gej-burrave, biseksualet dhe personave transgjinor dhe të promovohet durim ndaj tyre. Me këtë ndryshim, Komisionit për Mbrojtje nga Diskriminimi do të mundësohet një hapësirë në të cilën vazhdimisht do të rishqyrtojë masat aktuale dhe tjera, si dhe të mbledh dhe të analizojë të dhënat relevante për të ndjekur dhe të konstatojë çdo diskriminim i drejtë ose jo-drejtë në bazë të orientimit seksual ose identitetit gjinor. Në fund, me këtë do të fitohet një mjet efektiv juridik para autoriteteve kombëtare, që do të mundësojë viktimat e diskriminimit të vetëdijesohen për ekzistimin e këtij mjeti dhe me atë do të fitohen edhe masa për luftë kundër diskriminimit që përfshijnë sanksione për shkeljet dhe dispozita për zhdëmtimin përkatës të viktimave.

### 3. Ndryshimi i Kodit Penal

Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë njih kreme të urrejtjes vetëm nëse kanë bazë kombëtare, racore ose fetare, ndërsa orientimi seksual dhe identiteti gjinor nuk parashihen si baza për krim të urrejtjes. Sipas dispozitave të Kodit Zgjedhor, orientimi seksual dhe identiteti gjinor nuk mund të merren si faktor rëndues gjatë përcaktimit të sanksioneve për krim të kryer penal dhe deri më tani nuk ka ndonjë vendim gjyqësor me të cilën do të dëshmohet e kundërta. Nuk ka të dhëna të mbledhura në lidhje me këto krime të urrejtjes dhe incidente tjera të shkaktuar nga urrejtja dhe nuk ka të dhëna në lidhje me diskriminimin në bazë të orientimit seksual dhe identitetit gjinor, dhe nuk ka zgjidhje për pesë nga gjashte sulmet të LGBTI qendrës. Nga kjo, mund të konstatohet që institucionet shtetërore nuk kanë politikë të caktuar qartë për luftë kundër këtyre krimeve. Duhet patjetër të ndryshohet Kodi Penal në pjesën e krimeve të urrejtës në mënyrë që orientimi seksual dhe identiteti gjinor do të jenë baza themelore për krime të urrejtjes. Përveç kësaj, duket qartë që pjesa më e madhe e nëpunësve policor, të punësuarit në gjykatat dhe burgjet nuk kanë vizituar asnjëherë trajnime si të reagojnë gjatë krimeve të urrejtjes, që bazë e kanë orientimin seksual ose identitetin gjinor. Për të qenë efektiv ndryshimi ligjor do të duhet të dedikohet vëmendje edhe

në pjesën e trajnimit dhe përgatitjes së institucioneve kompetente për përballim me këto lloje të krimeve. Me këtë ndryshim, Ministrisë së Punëve të Brendshme, Sektorit për Kontroll të Brendshëm dhe Standarde profesionale dhe Qendra për Trajnime (si organe në përbërje të MPB-së), Akademia e Gjykatësve dhe Prokurorëve Publik dhe Drejtorisë për Zbatimin e Sanksioneve do të mundësohet që të mbledhin dhe analizojnë të dhëna për kryerjen dhe karakterin e krimeve dhe diskriminimit në këtë fushë. Me këtë hapet një hapësirë për mprehjen e masave në luftën kundër të folurit e urrejtjes në bazë të orientimit seksual ose identitetit gjinor, përfshirë edhe ligje sipas të cilëve do të ndëshkoheshe ky lloj i të folurit të urrejtjes. Në kohën e njëjtë, do të promovohen praktika të mira në mediet dhe dhënësit e shërbimeve në internet. Përfaqësuesit politik në mënyrë publike do të shprehnin zero tolerancë ndaj të folurit e urrejtjes, veçanërisht në bazë të orientimit seksual dhe identitetit gjinor.

#### 4. Ndryshim i Ligjit për Familje

Republika e Maqedonisë ka dekriminalizuar homoseksualitetin në vitin 1996, që do të thotë që prej atëherë personat janë të lirë të kenë lidhje homoseksuale. Moshë e pjekurisë për pëlqim për marrëdhënie seksuale në Maqedoni është e njëjtë si për homoseksualët ashtu edhe për heteroseksualët. Në Kodin Penal nuk ka dispozita që për shkak të fjalëve që përmbajnë ose shtrirjen që e kanë, do të mund të mënyrë diskriminuese të përdoren në lidhje me orientimin seksual ose identitetin gjinor. Megjithatë, në përputhje me Nenin 15 të Ligjit për Familje, kurorë mund të bëjnë dy persona të gjinisë së ndryshme, që do të thotë që çiftet e gjinive të njëjta janë diskriminuar me Ligjit për Familje në lidhje me çiftet me partnerë të gjinisë së ndryshme. Në përputhje me dispozitat në fuqi, çiftet e gjinive të njëjta nuk njihen nga shtetit, dhe nuk kanë asnjë lloj të drejte. Në Ligjin për Familje janë përcaktuar të drejtat dhe obligimet vetëm të çifteve të pamartuar heteroseksuale, ndërsa marrëdhëniet e afërta dhe personale janë përcaktuar si marrëdhënie mes personave me gjini të ndryshme të cilët kanë qenë në lidhje, por nuk jetojnë në bashkësi jashtëmartesore. Nga kjo del që autoritetet nuk kanë ndërmarrë asnjë masë për zgjidhje të problemeve të përditshme të çifteve të gjinisë së njëjtë. Ata ende janë në mënyrë të hapur të diskriminuar kur bëhet fjalë për të drejtat pronësore, dhe nuk janë marrë masa për mbrojtjen nga diskriminimi në bazë të orientimit seksual ose identitetin gjinor në

lidhje me të drejtat prindërore, birësimit dhe kujdestarinë mbi një fëmijë. Për të tejkaluar këtë diskriminim, ndryshimet në Ligjin për Familje duhet të garantojnë barazi mes çifteve të gjinisë së njëjtë dhe çifteve me partnerë të gjinisë së ndryshme, si në bashkësi martesore ashtu edhe jashtëmartesore. Në këtë mundësi do të mundësohet mbrojtje e LGBTI personave në lidhje me të drejtat pronësore dhe do të hapet hapësirë për punë në fushën e veprimit jo-diskriminues në lidhje me të drejtat prindërore, birësimit dhe kujdestarisë mbi fëmijë..

## 5. Miratimi i rregullores për njohje sistematike të ndryshimit të gjinisë

Në Republikën e Maqedonisë nuk ka procedura të përcaktuar saktë dhe të qartë për ndryshim të numrit amë, që është e domosdoshme për njohjen ligjore të ndryshimit të gjinisë në rast të personave transgjinator. Nga këto arsye krijohet konfuzion në veprimin e nëpunësve shtetëror, por edhe vetë tek personat transgjinator. Ndonëse shtetit ofron trajtime endokrinologjike dhe psikologjike, që janë të nevojshme për personat transgjinator, ato nuk janë efektive, as përkatëse, nga shkak që nuk ka praktikë, as trajnime për punëtorët profesional shëndetësor në rast të personave transgjinator, gjegjësisht në procesin e ndryshimit të gjinisë. Shteti nuk ofron asnjë intervenim kirurgjik për ndryshim të gjinisë dhe nuk ka dëshmi për kompensim të mjeteve nga Fondi për Sigurim Shëndetësor, madje edhe në raste kur personat kanë bërë operacionin në vend tjetër, me mjete personale. Me këtë, shteti shkal të drejtën e garantuar kushtetuese të mbrojtjes shëndetësore<sup>16</sup> të gjithë qytetarëve, mes të cilëve edhe të LGBTI personave. Sipas Ligjit për Emër Personal<sup>17</sup>, secili qytetar ka të drejtë të ndryshojë emrin dhe mbiemrin personal, por kur bëhet fjalë për ndryshim të numrit amë, që përmban kod për gjininë e personit, nuk është e qartë cili organ ka për obligim të ndryshojë. Shembujt nga praktika dëshmojnë që procedura për ndryshim të numrit amë nuk është saktë e përcaktuar. Për shembull, në një rast, dy persona transgjinator, të cilët duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë në procesin e ndryshimit të numrit amë, në kushtet e njëjta e fillojnë procedurë në

16...


16 Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, neni 39, "Gazeta zyrtare e RM", nr. 52/91.


17 Ligji për emër personal, "Gazeta zyrtare e RM", nr. 8/95.




qytete të ndryshme, pa mos bërë intervenime kirurgjike, dhe fitojnë rezultate të ndryshme. Për gjitha këto arsye, shteti duhet të garantojë njohje të plotë ligjore të ndryshimit të gjinisë të personit në mënyrë të shpejtë, transparent dhe lehtë. Më tutje, shteti duhet të sigurojë qasje të personave transgjinator në shërbime përkatëse për ndryshim të gjinisë dhe të largojë gjitha pengesat që e kufizojnë mundësinë që shpenzimet të mbulohen me sigurim shëndetësor, dhe shpenzimet që takojnë për mbulim personave transgjinator duhet të jenë të ligjshme, objektive dhe proporcionale. Me këtë do të mundësohet një procedurë e unifikuar për njohje sistematike të ndryshimit të gjinisë, që do të përfshijë procedura të thjeshta ligjore dhe shëndetësore, me ndarje të qartë të kompetencave mes Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe drejtorisë për Udhëheqje me Libra Amzë.

...17







# ...19 III Legjislatura pozitive në lidhje me LGBTI komunitetin

Me ligjet e theksuar më lartë mbulohen fushat kryesore në të cilat duhet ndryshime ligjore që do të mundësojnë barazimin e të drejtave të LGBTI personave me gjithë qytetarët. Për të fituar një pasqyrë të legjislaturës pozitive në lidhje me LGBTI personat, në vazhdim janë dhënë dispozitat ligjore dhe aktet nënligjore që përmendin dhe rregullojnë të drejtat e lidhur me orientimin seksual dhe identitetin gjinor.

## Ligji për Mbrojtje, Parandalim dhe Pengim nga Dhuna Familjare

Në Nenin 3 të Ligjit është përcaktuar dhuna familjare dhe thuhet: Me nocionin dhunë në familje nënkuptohet keqtrajtimi, ofendimi, rrezikimi i sigurisë, lëndimi trupor, dhuna gjinore apo dhuna tjetër psikologjike, fizike ose ekonomike me të cilën shkaktohet ndjenja e pasigurisë, rrezikimit ose frikës, duke përfshirë edhe kërcënime për veprime të tilla, ndaj bashkëshortit, prindërve ose fëmijëve ose personave tjerë që jetojnë në bashkësi martesore ose jashtëmartesore ose ekonomi të përbashkët

familjare, si dhe ndaj bashkëshortit të tanishëm apo të mëparshëm, partnerit jashtëmartesor ose personave që kanë fëmijë të përbashkët ose janë në marrëdhënie të afërta personale, pa marrë parasysh nëse kryerësi e ndan ose e ka ndarë vendbanimin e njëjtë me viktimën ose jo. Duke marrë parasysh që partnerët nuk janë përcaktuar sipas gjinisë së tyre në nenin më lartë, formulimi “ose persona tjerë që jetojnë në gjendje jashtëmartesore ose amvisëri të përbashkët” i mbron çiftet e gjinisë së njëjtë nga dhuna familjare. Nëse më tepër, përcaktimi i gjerë që vijon “personat që gjendjen në marrëdhënie të afërta personale” tërësisht i përfshin edhe bashkësitë mes dy burrave ose dy grave dhe me atë e garanton mbrojtjen, pengimin dhe parandalimin nga dhuna familjare për këto grupe.

### Ligji për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale

Në Nenin 53 të Ligjit që rregullon komunikimin komercial audio-vizual është përcaktuar që komunikimet komerciale audio-vizuale nuk guxojnë të përfshijnë ose promovojnë çfarëdo diskriminimi në bazë të gjinisë, racës, përkatësisë etnike, kombësisë, fesë ose besimit, mangësitë fizike, moshës ose orientimit seksual. Me këtë nen në mënyrë kategorike është theksuar orientimi seksual si një prej bazave për mbrojtje nga diskriminimi. Megjithatë, edhe në këtë ligji identiteti gjinor nuk është mbrojtur si bazë e veçantë.

### Ligji për Shëndet Publik

Ligji për Shëndet Publik në Nenin 16 i përcakton parimet për kryerjen e punës të Institutit dhe qendrave për shëndet publik në Republikën e Maqedonisë. Kryerjen e punëve nga Neni 10 dhe 11 i këtij Ligji, Institutit dhe Qendrat e bazojnë në gjashtë parimet prej të cilëve një është ndërmarrja e intervenimeve që nuk do të diskriminojnë personat në bazë të racës, gjinisë, kombësisë së ndryshme dhe origjinën sociale ose gjendjen pronësore, besimin fetar, gjininë, orientimin seksual ose statusin e personit me nevoja të posaçme. Gjendja në këtë ligji është

identike me parandalimin që e jep Ligji për Shërbime Mediatike Audio dhe Audio-vizuale, duke mbrojtur orientimin seksual, por duke injoruar identitetin gjinor.

### Ligji për Plotësim dhe Ndryshim të Ligjit për Familje – Kujdestari mbi persona të mitur – viktima të tregtisë me qenie njerëzor<sup>e18</sup>

Më 19.07.2008 në fuqi hyn Ligji për Plotësim dhe Ndryshim të Ligjit për Familje. Me këto ndryshime, sipas Nenit 177 të Ligjit, shtohet një Kapitull V-a “Kujdestari mbi persona të mitur – viktima të trafikimit me qenie njerëzore”, që numëron 16 nene. Neni 177-l përcakton që ndihma e fëmijës-viktimë e trafikimit me qenie njerëzore dhe të familjes jepet pa dallim nga feja, raca, gjinia, përkatësia kombëtare ose origjina sociale, veçoritë gjenetike, gjuha, religjioni, aftësitë psikike ose fizike, *orientimi seksual*, mosha dhe tjera. Përveç faktit që lista përmban pjesë të hapura me përcaktimin e “tjera”, identiteti gjinor sërish nuk është theksuar si bazë e veçantë për mbrojtje.

### Ligji për të Drejtat e Pacientëve

Neni 5 i këtij ligji i mbron pacientët nga diskriminimi dhe përcakton që pacienti ka të drejtë të realizimit të të drejtave të përcaktuara me këtë ligji, pa diskriminim të bazuar në gjini, racë, ngjyrë të lëkurës, gjuhë, besim, mendim politik ose tjetër, origjinë kombëtare ose sociale, përkatësi të minoriteteve kombëtare, gjendja materiale, origjinë pa lindjes, *orientimit seksual* ose në ndonjë statusi tjetër të caktuar. Një situatë identike me atë të ndryshimeve të Ligjit për Familjen, përveç që në listë mbetet e hapur me përcaktimin “ndonjë statusi tjetër të caktuar”, identiteti gjinor sërish nuk është theksuar si bazë e veçantë për mbrojtje.

### Ligji për Arsimin e Lartë

Në Nenin 5 të Ligjit që rregullon kushtet dhe mënyrën e regjistrimit të studimeve është përcaktuar që universiteti, gjegjësisht shkolla e pavarur e lartë profesionale e përcakton procedurën e përzgjedhjes së kandidatëve për regjistrim në mënyrë që garanton barazi për gjithë

18 Ligji për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për familje, “Gazeta zyrtare e RM”, nr. 153/2014.

kandidatët pa dallim nga raca, ngjyra e lëkurës, gjinia, gjuha, feja, besimi politik ose tjetër, origjinë etnike, kombëtare ose sociale, pronë, lindje, gjendja shoqërore, aftësitë fizike, orientimit seksual dhe mosha. *Orientimi seksual* është theksuar si bazë e veçantë për mbrojtje, por sërish identiteti gjinor nuk është përfshirë në listën e mbyllur të bazave.

### Rregullore për teknika të reja reklamuese - Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele

Me këtë rregullore përcaktohen rregullat për përdorim të teknikave të reja reklamuese nga ana e dhënësit të shërbimeve mediatike audiovizuele dhe ka për qëllim të mbrojë shikuesit nga ekspozimi i tepërt i reklamimit të markave të ndryshme dhe praktikave të pandershme komerciale. Në nenin 11 për mbrojtje të konsumatorëve është përcaktuar që teknikat e reja reklamuese nuk guxojnë të përfshijnë dhe të promovojnë asnjë diskriminim në baza taksative, mes të cilave edhe orientimi seksual. Identiteti gjinor si bazë e veçantë sërish nuk është përfshirë.

### Udhëzim për Vendosjen e Produkteve - Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele

Me këtë udhëzim përcaktohet mënyra e zbatimit të dispozitave për vendosjen e produkteve. Në rregullat e përgjithshme është përcaktuar që vendosja e produkteve nuk guxon të vendos në pyetje respektimin e dinjitetit të njeriut dhe/ose të përfshijë ose të promovojë çfarëdo diskriminimi në baza taksative të caktuara, mes të cilave edhe orientimi seksual. Identiteti gjinor sërish nuk është përfshirë si bazë e veçantë.

Nga kjo më lartë mund të arrijmë në konkluzion që orientimi seksual përmendet pothuaj se në gjitha aktet ligjore dhe nënligjore në fushën e medie, shëndetit dhe sociale. Nga ana tjetër, arrijmë në konkluzion që identiteti gjinor aspak nuk ekziston në sistemin ligjor maqedonas, që do

të thotë që personat transgjinnor dhe personat interseks janë tërësisht padukshëm për ligjvënësin dhe për administratën publike.

## ...23

# IV Hulumtime ndërkombëtare dhe tregues dhe rekomandime për RM-në

Për të fituar një perspektivë më të gjerë për gjendjet në legjislaturën dhe pasojat e tyre në jetën e vërtetë, në vazhdim do të përqendrohemi në zbulimet nga ILGA Evropë – dega evropiane e organizatës më të madhe për mbrojtje dhe realizim të të drejtave të LGBTI komunitetit. ILGA Evropë çdo vit publikon raporte individuale për përparimin (ose zmbropsjen) e gjendjeve në vendet e Evropës dhe i dorëzon në Komisionin Evropian.


Në raportin e tyre për Maqedoninë për vitin 2016<sup>19</sup>, ILGA jep tre rekomandime kryesore për përmirësimin e kornizës ligjore në lidhje me të drejtat e LGBTI personave. Rekomandimi i parë është prezantimi i dispozitave konkrete ligjore që do të mbrojnë të punësuarit nga diskriminimi në bazë të orientimit seksual, identitetin ligjore dhe/ose veçoritë seksuale. Rekomandimi i dytë është zhvillim i kornizës të drejtë

19 Raporti i ILGA Evropë për vitin 2016: [http://ilga-europe.org/sites/default/files/2017/fyr\\_macedonia.pdf](http://ilga-europe.org/sites/default/files/2017/fyr_macedonia.pdf).

dhe transparente për njohje ligjore të gjinisë, e bazuar në parimin e vetë-përcaktimit dhe liruar nga kushte fyerës dhe jonjerëzore (si sterilizim, diagnoza mjekësore dhe/ose intervenime kirurgjike). Rekomandimi i fundit përqendrohet në problemin e gjerë dhe të përhapur të të folurit e urrejtjes në Republikën e Maqedonisë. ILGA Evropë rekomandim të prezantohen zgjidhje ligjore për ndalimin e të folurit të urrejtjes në të cilat në mënyrë eksplicite do të theksohen orientimi seksual, identiteti gjinor dhe veçoritë seksuale si baza të mbrojtura.

Për një pasqyrim më të mirë, ILGA Evropë çdo vit publikon hartën e ylberit<sup>20</sup> në të cilën numërohen vendet e Evropës në përparimin drejt realizimit të të drejtave të LGBTI personave. Maqedonia edhe këtë vit është në mesin e vendeve të fundit, në vendin e 41 të pa preferuar, prej 49 shteteve, në shoqërimin e Bjellorusisë, Azerbajxhanit, Ruisë dhe Turqisë. Sipas konkluzioneve të ILGA Evropë, Maqedonia ka realizuar vetëm 16% të zgjidhjeve të nevojshme ligjore që i mbrojnë dhe garantojnë të drejtat dhe liritë e LGBTI komunitetit. Në vazhdim kemi prezantuar indeksin e zbërthyer të kritereve<sup>21</sup> me shënim që cilat kritere janë, gjegjësisht nuk janë realizuar në Republikën e Maqedonisë.

24...



20 Harta e ylberit e ILGA Evropë: <https://rainbow-europe.org/>.

21 Indeks i kritereve të ILGA Evropë:  
[http://www.ilga-europe.org/sites/default/files/Attachments/side\\_b-rainbow\\_europe\\_index\\_may\\_2016\\_small.pdf](http://www.ilga-europe.org/sites/default/files/Attachments/side_b-rainbow_europe_index_may_2016_small.pdf).



Barazi dhe jo-diskriminim

...25


✗ Realizuar	✓ Perealizuar
Njohje kushtetuese (orientimi seksual)	Qasje në mallra dhe shërbime (orientimi seksual)
Mbrojtje gjatë punësimit (orientimi seksual)	Qasje në arsim (orientimi seksual)
Terapi për konversion (orientimi seksual)	Qasje në shëndet publik (orientimi seksual)
Autoritet shtetëror për barazi (orientimi seksual)	
Plan veprimi për barazi (orientimi seksual)	
Njohje kushtetuese (identiteti gjinor)	
Mbrojtje gjatë punësimit (identiteti gjinor)	
Qasje në mallra dhe shërbime (identiteti gjinor)	
Qasje në arsim (identiteti gjinor)	
Qasje në shëndet publik (identiteti gjinor)	
Terapi për konversion (identiteti gjinor)	
Autoritet shtetëror për barazi (identiteti gjinor)	
Plan veprimi për barazi (identiteti gjinor)	
Ligj për shprehje të lirë gjinore	
Ligj për mbrojtje të integritetit trupor të interseks personave	
Politika për mbrojtje të interseks personave	

## Familja

 Realizuar	 Perealizuar
Barazi të martesave	Mungesa e ndalesës kushtetuese për martesë të gjinisë së njëjtë
Partneritet i regjistruar (të drejta të njëjta)	Shumimi i ndihmuar mjekësor (prindër i vetëm)
Partneritet i regjistruar (të drejta të kufizuara)	
Bashkëjetesë	
Birësim i përbashkët	
Birësim nga ana e prindërit të dytë	
Njohje automatike e bashkë-prindërit	
Shumimi i ndihmuar mjekësor (çifte)	
Person transgjinnor mund të martohet me persona të gjinisë së kundërt	

26...

## Të folurit dhe vepra të urrejtjes

 Realizuar	
Ligji për vepra të urrejtjes (orientimi seksual)	Ligj për të folurit e urrejtjes (identiteti gjinor)
Ligji për të folurit e urrejtjes (orientimi seksual)	Politika për përballimin me urrejtjes (identiteti gjinor)
Politika për përballimin me urrejtjen (orientimi seksual)	Ligji për vepra të urrejtjes (interseks)
Ligj për të folurit e urrejtjes (identiteti gjinor)	Politika për përballim me urrejtjes (interseks)

## Njohja ligjore e gjinisë dhe integritet trupor

✗ Realizuar	✓ Perealizuar
<p>Mekanizma të përhershme ligjore</p> <p>Procedura të përhershme administrative</p> <p>Mungesa e kufirit të moshës për ndryshim të emrit</p> <p>Mungesë e diagnozave të kushtëzuara mjekësore/psikologjike për çrregullim gjinor</p> <p>Mungesa e intervenimeve të detyrueshme mjekësore</p> <p>Mungesa e intervenimeve të detyrueshme kirurgjike</p> <p>Mungesa e sterilizimit të detyrueshëm</p> <p>Mungesa e kufizimit të moshës</p> <p>Ndalesë për intervenim mjekësor para se fëmija të jetë i aftë të jep pëlqimin personal (interseks)</p>	<p>Ndryshim i emrit</p> <p>Mungesë e shkurorëzimit të detyrueshëm</p>


...27

## Hapësirë në shoqërinë

qytetare

Azil

✓ Perealizuar	✗ Realizuar
<p>I zhvilluar një ngjarje publike pa pengesë nga shteti për të drejtën e grumbullimit të lirë (3 vite)</p> <p>Funksionim i shoqatave dhe organizatave pa pengesë të drejtës së grumbullimit (3 vite)</p> <p>Mungesë e ligjit për kufizim të së drejtës për shprehje të lirë (nivel kombëtar dhe lokal)</p>	<p>Ligji për azil (orientimi seksual)</p> <p>Politika/masa tjera pozitive (orientimi seksual)</p> <p>Ligji për azil (identiteti gjinor)</p> <p>Politika/masa tjera pozitive (identiteti gjinor)</p> <p>Ligji për azil (interseks)</p> <p>Politika/masa tjera pozitive (interseks)</p>



# REKOMANDIME

në lidhje me kornizën ligjore  
për të drejtat e LGBTI komunitetit  
në Republikën e Maqedonisë

Nga ato të theksuar më lartë dalin disa rekomandime:

1. Me urgjencë të jepet përgjigje për hetimet kundër sulmuesit të LGBTI Qendrës për Mbështetje dhe LGBTI personave, sepse mos ndëshkimi i sulmuesve paraqet diskriminim ndaj LGBTI personave, si grup i marginalizuar, që tërësisht e humb besimin në institucionet.
2. Miratimi i strategjisë së plotë për tejkalimin e homofobisë dhe transfobisë/plan veprimi për Strategjinë Kombëtare për Barazi dhe Jo-Diskriminim 2016-2020.
3. Në kohë sa më të shpejtë të fillohet me përgatitjen e ndryshimeve të Ligjit për Parandalim dhe Mbrojtje nga Diskriminimi, veçanërisht në pjesën e qasjes së drejtësisë për viktimat e diskriminimit, gjegjësisht liritimit nga shpenzimet gjyqësore për nisje të procedurës gjyqësore për mbrojtje nga diskriminimi, pavarësi të Komisionit për Mbrojtje nga Diskriminimi dhe kyçje të orientimi seksual dhe identitetit gjinor si baza për diskriminim.
4. Prezantimi i zgjidhjeve ligjore për ndalimin e të folurit të urrejtjes në të cilat në mënyrë eksplicite do të theksohen orientimi seksual, identiteti gjinor dhe veçoritë seksuale si baza të mbrojtura.
5. Prezantimi i dispozitave konkrete ligjore që do të mbrojnë të punësuarit nga diskriminimi në bazë të orientimit seksual, identitetin ligjor dhe/ose veçoritë seksuale.

6. Miratimi i kornizës të drejtë dhe transparente për njohje ligjore të gjinisë, e bazuar në parimin e vetë-përcaktimit dhe liruar nga kushte fyerës dhe jonjerëzore (si sterilizim, diagnoza mjekësore dhe/ose intervenime kirurgjike).
7. Ndryshime në Ligjin për Familje duhet të garantojnë barazi mes çifteve të gjinisë së njëjtë dhe çifteve me partnerë të gjinisë së ndryshme, si në bashkësi martesore ashtu edhe jashtëmartesore.

30...



# VKonkluzion

Pas përshkrimit të problemeve dhe zgjidhjeve të preferuara ligjore, shqyrtimi i legjislaturës pozitive në lidhje me LGBTI komunitetin dhe krahasimi i hulumtimeve dhe treguesve ndërkombëtar, si dhe rekomandimet për Republikën e Maqedonisë mund të arrihet në konkluzion që janë të nevojshme reforma urgjente të domosdoshme dhe efikase për të siguruar të drejtat themelore të njeriut për LGBTI komunitetin në Republikën e Maqedonisë. LGBTI komuniteti në shtet do të mbështet thellë e marginalizuar deri sa nuk zbatohen rekomandimet e dhënë. Klima shumëvjeçare e armiqësisë së përgjithshme ndaj LGBTI komunitetit në mediet kryesore, strukturën politike dhe shoqërinë, si dhe mungesa e marrjeve të masave me të cilat do të parandalohen të folurit e urrejtjes dhe veprat e urrejtjes kundër LGBTI individëve, ka kontribuar për keqësimin e vazhdueshëm të situatës, duke vendosur shtetin në fund të kontinentit evropian. Sot, LGBTI personat jetojnë në frikë të vazhdueshme dhe në margjinat e shoqërisë pa asnjë garanci nga ana e shtetit që do të mbrohen në rast të sulmit. Të gjitha këto ofrojnë argumente të mjaftueshme që lufta për ndryshim nuk guxon të pritët asnjë ditë, sepse LGBTI të drejtat janë të drejtat e njeriut.

...31





## Aneksi1:

# Gjendja me LGBTI të drejtat në vendet e Ballkanit Perëndimor

...33

Vendet e Ballkanit Perëndimor në të cilën bëjnë pjesë Maqedonia, Shqipëria, Kosova, Mali i Zi, Serbia, Bosnja dhe Hercegovina dhe Turqia (ndonëse nuk përputhet në kuptimin gjeografik, Turqia në mënyrë tradicionale bënë pjesë në këtë grup, si vend-aspirant për anëtarësim në BE nga rajoni), në mënyrë historike kanë problem me sigurimin e të drejtave dhe mundësive të barabarta të LGBTI komunitetit. Faktorët për këtë janë të shumtë, por vetëm disa janë periudha e tranzicionit nga vitet e nëntëdhjeta, zhvillimi i dobët ekonomik si dhe ideologjia dominuese konservatore. Megjithatë, periudha e kaluar ka qenë një periudhë për lëvizje drejt sigurimit të kornizës ligjore për mbrojtje të të drejtave të komunitetit, ndonëse ajo jo çdoherë është pasqyruar në realitetin. Shqipëria, Kosova, Mali i Zi, Bosnja dhe Hercegovina dhe Serbia kanë arritur përparim të rëndësishëm, por për fat të keq nuk mund të thuhet edhe për Maqedoninë dhe Turqinë. ILGA Evropë në konkluzionet dhe raportet e saja ka theksuar reformat vijuese të arritura nga vendet e Ballkanit Perëndimor për vitin 2016:

### Bosnja dhe Hercegovina

Viti i kaluar në Bosnje dhe Hercegovinë ka kaluar në shenjën e miratimit të dira akteve dhe politikave ligjore. Një hap pozitiv ishte miratimi i planit të veprimit kundër diskriminimit, që paraqet një dokument i parë

i këtij lloji që në nivelin kombëtar në mënyrë eksplicite i mbron personat LGBTI. Më tutje, gjuha në ligjin aktual federal kundër diskriminimit ishte reviduar dhe sqaruar, dhe veçoritë seksuale ishin shtuar në listën e bazave të mbrojtura në gjitha fushat e jetës. Megjithatë, vështirësitë e përditshme me të cilat përballohen personat interseks, si mungesa e procedura të miratuara në institucionet shtetërore kur veprohet me fëmijë interseks, edhe më tutje vazhdojnë të jenë një prej vërejtjeve të organizatave qytetare. Nga ana tjetër, edhe një grup në komunitetin e gjerë të LGBTI, që edhe më tutje përballohet me barriera, janë LGBTI personat që nuk janë shtetas të BH, kërkuesit e azilit, të cilët ende nuk kanë mbrojtje ligjore në Bosnjë dhe Hercegovinë. Ky problem është aktual edhe sot, ndonëse vitin 2016 shteti ka miratuar ligjin për azil, të përpunuar sipas standardeve të BE-së. Aktivistët dhe mbështetësit e LGBTI ofruan amendamente, por ato nuk ishin marrë parasysht. Në pjesën e dytë të vitit, një politikan i mirënjohur deklaroi mbështetje publike për komunitetin, diçka që erdhi pas inkurajimit të Avokatit të Popullit në raportin e tij të veçantë për të drejta e njeriut në vend. Si krahasim, mund të arrijmë në konkluzion që Bosnja dhe Hercegovina ka arritur një përparim më të madh nga Maqedonia në fushat e barazisë dhe jo-diskriminimit, mbrojtjes ligjore nga të folurit dhe veprat e urrejtjes, si dhe kornizë ligjore për sigurimin e azilit. Nota e përgjithshme e ILGA për Bosnjën dhe Hercegovinën, përfshirë edhe vitin 2016, është 31%, madje 15% më të lartë se Maqedonia.

## Kosova

Nevoja për ligje për barazi është futur në diskursin publik në Kosovë në vitin 2006. Një grup që punon për LGBTI dhe të drejtat e LGBTI citoi rritjen e vetëdijes dhe përmirësimin e politikave ekzistuese kundër diskriminimit si qëllime kryesore. Komisioni evropian në drejtimin vjetor për zgjerim ju bëri thirrje udhëheqësve të mbështetimit komunitet. Një hulumtim i organizatave joqeveritare tregoi se nevojitet senzibilizim i punëtorëve shëndetësor për përgjegjësinë e tyre ndaj personave LGBTI të cilët kanë nevojë për ndihmë mjekësore. Hulumtimi gjithashtu përfshin rekomandime për mbrojtje minimale shëndetësore të personave transgjiner në Kosovë. Në mungesë të politikave mirë të zhvilluara për ballafaqim me gjuhën dhe veprat e urrejtjes, organizatat joqeveritare vazhdojnë të ofrojnë përkrahje dhe ndihmë personave LGBTI – viktima të

dhunës që nuk kanë mbrojtje institucionale. Krahasuar me Maqedoninë, Kosova ka arritur përparim më të madh në fushën e barazisë dhe mosdiskriminimit, si dhe kornizës ligjore për sigurim të azilit. Sidoqoftë, realiteti në Kosovë tregon se ndryshime pozitive ligjore nuk zbatohen mjaftueshëm në teren. ILGA, për vitin 2016, Kosovës i dha notë prej 30% të përparimit të arritur kah korniza ligjore tërësisht e adaptuar për të drejta të barabarta të personave LGBTI.

## Shqipëria

Shqipëria është shembulli më i mirë për dallimet mes ligjeve në letër dhe realitetit që e përfshijnë personat LGBT në përditshmërinë e tyre. Në vitin 2016 Shqipëria arriti përparim legjislativ, duke miratuar planin e veprimit për promovim dhe mbrojtje të të drejtave njerëzore të komunitetit. Sidoqoftë, nuk ka pasur aspak përpjekje për thyer ambienti mbizotërues homofobik në shoqëri. Si shtet kandidat, Shqipëria ka marr vlerësime pozitive nga Bashkimi Evropian për përparimin e saj kah anëtarësimi në BE, por nivelet e ulëta të pranimit shoqëror të personave LGBTI është një prej fushave që Komisioni i ka nënvizuar si seriozisht brengos. Përskaft faktit që Shqipëria ka legjislaturë të vazhdueshme për barazi dhe dhunë të urrejtjes, kjo legjislaturë nuk zbatohet, përfshirë edhe trajnimin e nëpunësve përkatës. Kjo u theksua në disa anketa që treguan se nëpunësit publik mendojnë se nuk janë në kontakt me persona nga komuniteti në punën e tyre. Madje edhe aty ku ekziston legjislatura, njerëzit mund mos të dinës e ajo mbrojtje përfshin edhe LGBTI personat, siç u kuptua nga një raport në të cilin thuhet se të rinjtë nuk e kuptojnë sa duhet Ligjin kundër diskriminimit. Sidoqoftë, LGBTI aktivistët përpiqen të ndryshojnë narrativin publik dhe të rritin vetëdijen. Krahasuar me Maqedoninë, Shqipëria ka arritur përparim më të madh në fushën e barazisë dhe mosdiskriminimit, si dhe mbrojtje ligjore nga gjuha dhe veprat e urrejtjes. Nota e fundit e ILGA Evropë për Shqipërinë është 33%.

## Mali i Zi

Viti 2016nishte edhe një vit i vështirë për organizatat dhe aktivistët LGBTI, të cilët u ballafaquan me një sërë suksesesh por edhe sfidash. Aktivistët vazhduan të sigurojnë ekspertizë dhe trajnime, përfshirë

punëtorinë e parë për LGBTI – barazi për edukatorët që punojnë me fëmijë të moshës parashkollore. Inkurajon krijimi i rrjetit për LGTK gratë, si dhe ankesa që e dorëzuar aktivistët LGBTI kundër Kishës ortodokse serbe për gjuhë të urrejtjes të drejtuar kundër komunitetit LGBTI, që kishte rezultat pozitiv. Derisa Mali i Zi i vazhdonte përpjekjet të bëhet lider në rajon në promovimin e të drejtave të LGBTI- personave, aktivistët ishin cak të sulmeve, që shfaq mospërputhjen mes zhvillimit ligjor dhe mendimit të shoqërisë. Përkaj faktit që ekzistojnë ligje dhe politika, sipas konkluzionit vjetor të Komisionit evropian, zbatimi i vërtet vazhdon të jetë problematik. Mali i Zi ka arritur përparim më të madh në fushën e barazisë dhe mosdiskriminimit, si dhe mbrojtjes ligjore nga gjuha dhe veprat e urrejtjes. Nota e ILGA-s është madje 39%.

## Serbia

Nota vjetore e Serbisë nga ana e Komisionit Evropian është bazuar në zbatimin e rregullave pozitive ligjore. Të drejtat e personave LGBTI janë përfshirë në disa ligje për barazi dhe vepra të urrejtjes, por raporti për zgjerim thekson se nevojiten më shumë përpjekje për zbatimin e tyre. Është theksuar edhe nevoja për përkrahje më të madhe politike të komunitetit dhe ballafaqim me krimet e urrejtjes. Sa i përket bashkëpunimit politik, një analizë e materialeve të partive politike tregoi se vetëm një numër i vogël i partive specifikojnë LGBTI komunitetin në programet e tyre. Në ndërkohë, u emërua lezbikja e parë që publikisht ka deklaruar orientimin e vet seksual. Para pak kohe, Ana Brnabiç, u emërua si kryeministre e Republikës së Serbisë. Me akt të ri nënligjor të policisë, u vendos mbrojtja kundër diskriminimit në bazë të identitetit gjinor, por orientimi seksual ishte lënë anësh në këtë akt. Në fund të vitit, personat transgjinor vazhdojnë të ballafaqohen me situata ku nuk ka procedura të qarta për pranim ligjor të gjinisë. Krahasuar me Maqedoninë, Serbia ka arritur përparim më të madh në fushat e barazisë dhe mosdiskriminimit, si dhe në sigurimin e mbrojtjes ligjore nga gjuha dhe veprat e urrejtjes në bazë të orientimit seksual. Nota e ILGA-s për Serbinë për vitin 2016 është 30%.

## Turqia

Atmosferë klaustrofobike e përforcuar nga deklarimi i gjendjes së jashtëzakonshme pas përpjekjes për grusht shteti në korrik të vitit të kaluar – kjo është prapavija me të cilën LGBTI aktivistët ballafaqohen në Turqi. Afatet e vazhduara për arrestim pa akuzë dh ndihma juridike e kufizuar kontribuan që siguria e punës së gazetarëve, avokatëve dhe organizatave joqeveritare seriozisht të vihet në pikëpyetje. E gjithë kjo krijoi skenar ku liria e mbledhjes mund të kufizohet në emër të “masave kundër terroriste” dhe “sigurisë”, që rezultoi me ndalesën për marshin për IDAHOT në Ankara dhe marshet për krenari në Stamboll dhe Izmir. Zyrat e LGBTI organizatave joqeveritare të njohura u mbyllën me forcë për shkak të thashethemeve për rreziqe sigurie. Në periudhën e sezonit të krenarisë grupe ekstremiste drejtuan kërcënime serioze. LGBTI personat, veçanërisht transgratë, ishin viktimat e krimeve të urrejtjes, ku shumica prej tyre rezultuan me pasoja vdekjeprurëse. Vrasja brutale e transaktivistes së njohur Hande Kader shkaktoi revolte publike dhe proteste në Turqi, si dhe në kontinentin evropian. Të rëndësishme ishin dënimet e gjata me burg për personat që dhunuan aktivistin Kemal Ordek. U formua komiteti për të drejta njerëzore, por në kompetencat e tija nuk u fut mbrojtja e LGBTI personave nga diskriminimi. Këshilli i Evropës dhe institucionet tjera të BE-së shfaqën shqetësim serioz për statusin e grupeve të pakicave, veçanërisht të LGBTI personave. Komisioni evropian vlerësoi se ka zbrapsje në mbrojtjen e të drejtave themelore, që është trend veçanërisht shqetësues, duke marr parasysh mbrojtjen e vazhdueshme minimale për LGBTI personat. Maqedonia ka notë më të mirë vetëm nga Turqia në vendet e Ballkanit perëndimor. Krahasuar me Turqinë, Maqedonia ka arritur përparim të madh në fushën e barazisë dhe mosdiskriminimit dhe sigurimit të hapësirës për komunitetin në shoqërinë qytetare. Turqia nga ILGA Evropa është vlerësuar me një nga notat më të ulëta në Evropë, vetëm 9%.

